REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 740 120
Datë/Datum. 16.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Avdush Bajramaliu, *Eksperti shqyrtues i jashtëm*	*08.10.2020*	*18.10.2020*	Nr. i lëndës: 740/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 01.10.2020, OE "ARITECH"Sh.P.K.- Kilometri i 10 Prishtinë-Lipjan , ka parashtruar ankesë me nr: **740/20**, kundër Njoftimit mbi Anulimin e aktivitetit te prokurimit ,lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me pajisje të TI –së për nevojat e Agjencive të Pavarura"(Pjesa (lot) 4- Furnizim me pajisje teTI-se për nevojat e Agjencisë kundër Korrupsionit)** nr. të prokurimit: **UA/2016-20-2761-1-1-1**, me nr.te brendshme **AQP-AK-20-020-111** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë hapur**, lloji i kontratës: **furnizim**, vlera e parashikuar e kontratës: **27,500.00€. Per Llot.4.**

SHENIM: (Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së)

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues..

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE te OE.Ankues

Njoftimi për kontrate: 11.06.2020
Afati i hapjes : 23.07.2020 ora 14:00
Koha e hapjes: 23.07.2020 ora 14:00
Kriteret për dhënien e kontratës : Çmimi me i ulet
Vendimi i AK-se: 09.09.2020 ne këtë Njoftim për vendim, Shpërblehet OE.ankues edhe per Llot.4
Njoftimi për Anulimin e aktivitetit Llot.I- dhe Llot.-IV- (Llot ne proces ankimin me dt.17.09.2020)
Kërkesa për Rishqyrtim ne AK-ne 23.09.2020
Ankesa ne OSHP.01.10.2020

Pretendimet ankimore për shkeljet ligjore:
Neni 6: i Ekonomiciteti dhe Efikasiteti LPP-se;
Neni 59: Ekzaminimi,Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
Neni 62: Përfundimi i aktivitetit te prokurimit

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

Pretendimi 1 (LPP/Neni 6Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)

Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike,njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit

Pretendimi nr.2Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

5.Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacion dytësor lidhur me këtë çështje

6. Autoriteti kontraktues dotë konsiderojë një tendersi të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri ime të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse:(i) përmban vetëm gabime ose paqartësitë cilat mundtë korrigjohen pa ndryshua kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë,ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat,kushtet,dhe kërkesat tjera të parashtruara në njoftimin e kontratë s dhe në dosje ne tenderit;me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet,aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Pretendimi nr.3 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

Pretendimi 4 i OE. ANKUES

Ne me date 09.09.2020 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-se apo letrën standarde për tenderuesin e suksesshëm për Pjesët 2, 4, 5, 8 dhe 9.

Ndërsa me date 18.09.2020 kemi pranuar njoftimin mbi NJOFTIMI PËR ANULIMIN E AKTIVITETIT TË PROKURIMIT për Pjesën 4 (lot) 4- Furnizim me pajisje te TI-se për nevojat e Agjencisë kundër Korrupsionit

Arsyetimi mbi anulimin e Pjesës 4 është si ne vijim:
Pjesa (lot) 4- Furnizim me pajisje te TI-se për nevojat e Agjencisë kundër Korrupsionit anulohet per shkak te mungesës se mjeteve te deklaruara nga ana e njësisë se kërkesës-AKK citoj arsyetimin pas konsultimeve me Departamentin e Financave të AKK-se dhe Zyrtarin Kryesor Administrativ, kemi ardhur në përfundim se nuk ka mundësi ligjore të bëhet zotimi i mjeteve për blerjen e kompjuterëve në kategorinë e mallrave e shërbimeve, ku kanë qenë të planifikuara mjetet buxhetore për këtë aktivitet të prokurimit, pasi që vlera mbi 1,000.00 Euro, për njësi na e bënë të pamundur që mjetet të zotohen në kategorinë e planifikuar. AKK për vitin 2020 nuk ka të planifikuar në sistemin PIP asnjë projekt kapital. prandaj duke u bazuar ne arsyeshmërin e dhëne nga njësia e kërkesës-AKK ne duhet te bejm anulimin e kësaj pjese.
Buxheti i parapare për Pjesën 4 për këtë aktivitet te prokurimit ka qene **27,500 euro.**
Oferta e Aritech shpk për Pjesën 4 është **22,810.00 euro.**
Autoriteti juaj pasi qe ka marr vendim për shpërblim me kontrate Aritech shpk për Pjesën 4 ka vendosur te anuloj aktivitetin e prokurimit për këtë Pjese.
Ne lidhje me arsyetimin e AK-se për anulimin e aktivitetit te prokurimit ne dëshirojmë te theksojmë qe

ne si OE nuk jemi te detyruar te bëjmë dallimin e kategorive ne raport me blerjet te cilat realizohen nga Autoritetet kontraktuese.
Angazhimi i OE-ve mendojmë qe bazohet tek buxheti i parapare për tender apo për Pjesët si ne rastin konkret.
Për tenderin ne fjale vlera e parashikuar e kontratës ka qene **27,500.00 euro**
Kërkesa tek aneksi 1 ka qene e ndare ne 2 pozicione me gjithsej 22 njësi (pozicioni 1 - 20 cope AIO, pozicioni 2 – 2 cope Laptop).
Logjikisht nëse kemi 22 njësi dhe 27,500 euro buxhet, është e kuptueshme qe pritshmëri e AKK-se qartazi kane qene qe njësia e një artikulli do tejkaloj vlerën prej 1000 euro, ne te kundërtën vlera e parashikuar e buxhetit do te ishte rreth 20,000-21,000 euro.
Përpilimi I specifikimeve dhe buxhetimi nuk ka qene I rastësishëm nga AKK pasi qe tek pozicioni 1 – AIO ne baze te specifikimeve te detajuara deri ne çdo hollësi është e qarte qe artikulli tejkalon vlerën prej 1000+ euro.
Ne rastin si arsyetimi me larte nga AK për anulimin e aktivitetin e prokurimit ne si OE do te duhej te ishim te njoftuar edhe për pozicionet te cilat nuk mund te kalojnë buxhetin për shkak te kategorizimit si me larte.
Ne kemi paraqitur ofertën tone ne përputhje me specifikimin teknik siç është kërkuar nga AK përkatësisht nga njësia kërkuese.
Kërkesat e specifikimit teknik te vendosura nga njësia kërkuese për pozicionin me nr. 1 AIO kane ndikuar drejtpërdrejt ne ofertën tone ne aspektin financiar.
Besojmë qe është detyre e AK-se te bej zgjidhjen ne raport me kategorizimin e blerjeve si dhe ne raport me Aritech shpk te realizoj kontratën duke respektuar te gjitha kërkesat ne dosje te tenderit.
Ne si OE deri tani kemi njohur arsyetimin për përfundim te aktivitetit te prokurimit ne rast se kemi te bejme me tejkalim te buxhetit te parapare por nuk kemi hasur te përfundohet aktiviteti i prokurimit për shkak se vlera mbi 1000 euro nuk hyn ne kategorizimin per mallra dhe shërbime siç është potencuar ne arsyetimin për anulim te aktivitetit te prokurimit për Pjesën 4.
AK-ne ne lidhje me kërkesën tone për rishqyrtim me date 23.09.2020 ka dërguar përgjigjeje ne e-mail si ne vijm :

Pershendetje i nderuar,

Permes sistemit te e-prokurimit jemi njoftuar me kerkesen tuaj për Rishqyrtim për tenderin me titull: "Furnizim me pajisje të TI –së për nevojat e Agjencive te Pavarura- Pjesa (lot) 4- Furnizim me pajisje te TI-se per nevojat e Agjencise kundër Korrupsionit)
me nr. prokurimi AQP-AK-20-020-111.
Te nderuar me keqardhje ju njoftojme se, ndo afat ligjor për parashtrim të kerkesë per rishqyrtim ne organet e prokurimit publik ka skaduar.

Me respekt,

Muzaqet Raci

- Ne me date te njejte kemi kthyer pergjigje ne lidhje afatet ligjore si ne vijim:

Pershendetje te nderuar,

Njoftimi mbi anulimin e tenderit perkatesdhe Pjeses 4 (Lot 4) ne fjale eshte vendosur ne e-pasiurim me date 18.09.2020

Njoftimet te tjera ne procedurën e njejtë te prokurimit:

Data 18.09.2020 eshte dita zero.

Afati per kerkese per Rishqyrtim eshte 5 dite nga data e njoftimit (Anulimit) nga ana e AK-se.

Nga data 19.09.2020 deri me date 23.09.2020 eshte afati brenda te cilës duhet te dorëzohet kerkesa per Rishqyrtim!

Sot eshte dita e 5-te sipas afateve ligjore te percaktuara.

Prandaj ju lutem te Rishqyrtoni kerkesen tuaj sepse ne jemi brenda afateve ligjore te percaktuara.

Me respekt,

Faton Ibrahimi

Kerkojme nga Organi shqyrtues I prokurimit qe te merr vendim si ne vijim:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE "ARITECH SHPK" lidhur me tenderin me titull"/Furnizim me pajisje të TI –së për nevojat e Agjencive të Pavarura- Pjesa (lot) 4- Furnizim me pajisje te TI-se per nevojat e Agjencise kundër Korrupsionit"

ANULOHET Njoftimi mbi vendimin e Anulimit te aktivitetit te prokurimit "Agjencia Qendrore e Prokurimit - Prokurimet për AK" dhe tenderi të Rikthehet ne Rivleresim. AK-së, të i kërkohet qe te veproje ne perputhje me kerkesat ne dosje te tenderit dhe LPP.

.

Demet materiale

Dëme materiale direket humbja e fitimit te mohuar si dhe shpenzimet për përgatitje te kërkesës për Rishqyrtim.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kriteret e kerkuara nga AK-ja (për pretendimet qe ka OE ankues):	
Kapaciteti ekonomik dhe financiar	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga **OE. "ARITECH"Sh.P.K.- Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me pajisje të TI –së për nevojat e Agjencive të Pavarura" (Pjesa (lot) 4- Furnizim me pajisje te TI-se për nevojat e Agjencisë kundër Korrupsionit)"**, me nr.të prokurimit: **UA/2016-20-2761-1-1-1**, me nr.te brendshme **AQP-AK-20-020-111** iniciuar nga **Autoriteti kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).**

Kërkesa	

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

(Të përshkruhet vetëm vlërësimi i ofertësë OE ankues /ofertave, por të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Ne raportin e vlerësimit për procedurën"Furnizim me pajisjetë TI –së për nevojat Agjencive të Pavarura" Komisioni i vlerësimit ka bere vlerësimin dhe e ka përgatitur raportin e tij te vlerësimit.
Komisioni i vlerësimin ka bere vlerësimin ka përgatitur dhe hartuar raportin e vlerësimin për këtë procedurë ku ne këtë raport tek Lista e plotë standarde e radhitjes se tenderëve sipas Kriterit te dhënies **(Tenderi i përgjegjshëm me çmim me te lirë)** ,Ky komision e ka ber radhitjen e operatoreve ekonomik qe kane dale me te lire me dokumentacion te përgjegjshëm duke ja përcjell zyrës se prokurimit te AK.-se .Operatoret Ekonomik qe duhet te shpërblehen me Kontratë .ku ne mesin e tyre është edhe EO.Ankues qe ne 5 Llote ,ka dalë me i lire me dokuemtacion te kompletuar duke përfshi edhe Llot.in qe është ne proces ankimimi Llot.4

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

- N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga **OE. "ARITECH"Sh.P.K.- Prishtinë,** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me pajisje të TI –së për nevojat e Agjencive të Pavarura" (Pjesa (lot) 4-Furnizim me pajisje te TI-se për nevojat e Agjencisë kundër Korrupsionit)"**, me nr.të prokurimit: **UA/2016-20-2761-1-1-1**, me nr.te brendshme **AQP-AK-20-020-111** iniciuar nga **Autoriteti kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).**

OE "Aritech"Sh.p.k.- Kilometri i 10 Prishtinë-Lipjan

Pergjigje nr.ne pretendimet ankimore nr.1 Ekonomicitieti dhe efikasiteti

Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar procedure prokurimi:" **Furnizim me pajisje të TI –së për nevojat e Agjencive të Pavarura**", sipas procedurës se Furnizim –procedure e hapur ,vlera e madhe (sipas LOT-eve) , sipas kriterit çmimi me i lirë ku me dt.11.06.2020,është përgatitur Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit dhe është përcjell për publikim ne prokurimi elektronik. Procedura është zhvilluar për nëntë (9) Autoritetit Kontraktuese.

Hapja e ofertave është bere me dt.23.07.2020 ne ora 14:00, me gjithsej 11 ofertues (operator ekonomik). AK-në kete rast AQP-ja bene hapjen dhe e benë edhe vlerësimin e ofertave për këtë procedure ku komisioni i vlerësimit bene vlerësimi,përgatit raportin dhe ja rekomandon Zyrës se Prokurimit te AK-se për OE-te qe duhet te shpërblehen me kontratë, sipas LOT-eve. Ku OE ankues është për LOT 4.

Përgjigjeje pretendimet ankimore nr.2 neni 59 i LPP-se Ekzaminimi ,vlersimi dhe Krahasimi i tenderëve

Për këto pretendimi ankimore AK-ka themeluar Komisionin për Ekzaminimin,Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve konform nenit 59 te LPP-se dhe pikës 40 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operative për Prokurim Publik (RRUOPP). Komisioni i vlerësimit ka bere vlerësimin dhe ka përgatitur dhe hartuar raportin e vlerësimin për këtë procedurë ku ne këtë raport ne tek Lista e plotë standarde e radhitjes se tenderëve sipas Kriterit te dhënies se kontrates **(Tenderi i përgjegjshëm me çmim me te lirë).** Ky komision e ka bere radhitjen e operatoreve ekonomik qe kane dale me te lire me dokumentacion te përgjegjshëm duke ia përcjellur zyrës se prokurimit te AK-se. Operatoret Ekonomik qe duhet te shpërblehen me Kontratë , ku ne mesin e tyre është edhe OE ankues qe ne 5 Llote, ka dalë me i lire me dokumentacion te kompletuar duke përfshirë edhe LOT-in qe është ne proces ankimimi LOT – 4.

Pra, Ak njehere e ka shpërblyer me kontrate OE, me pastaj e ka anuluar.

Përgjigje ne pretendimet ankimore nr.3 neni 62 i LPP-se Përfundimi Aktivitet te Prokurimit

Lidhur me pretendimet ankimore te OE.ankues ato qëndrojnë plotësisht sepse një aktivitet prokurimi për një ofertues qe ka dalë i kompletuar ne vlerësim ekzaminin dhe krahasim te tenderëve, aktiviteti i prokurimit duhet te përfundon me dhënie te kontratës nëse OE është me i lire apo me i shtrenjtë, mirëpo kusht i tenderit eshte qe se paku te jete i kompletuar sipas kritereve te kërkuara sipas nenit 59.4 te LPP-së. Pra, ky OE eshte i kompletuar me dokumentacion te pergjegjshem.

Këto fakte gjenden edhe ne raportin e vlerësimit, ku OE-ja duhet të shpërblehet me kontratë dhe ti jepet kontrata për ofertën qe e ka dhënë.

AK ne këtë rast ka bere shkelje ligjore, sepse pas vlerësimit te ofertave, AK-ka përgatitur Njoftimin për Vendimin e AK-se duke e shpërblyer me kontrate OE ankues ne 5 LOT-e, përfshirë edhe LOT-in 4 qe është ne proces ankimimi.

OE.ankues,edhe për llotin e kontestuar madje pa i pasur mjetet e zotuara nga Agjencia Kundër Korrupsionit kjo shihet qartë ne Njoftimin e AK-se te dates: 09.09.2020 qe i ka te bashkangjitura edhe Letrat standarde ku ne Fq.12 te keti vendimi thuhet tekstualisht "**Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar ne tenderin tuaj për Pjesën 2) 5,188.00, Pjesën 4). 22,810.00 € (Lloti qe është ne proces ankimimi).për pjesën 5). 2,468.00 €,Pjesen 8).7,076.00 Pjesën 9). 3,560.00 €**,shkeljete janë te theksuara gjatë keti procesi sepse paraprakisht AK-AQP ne këtë rast është dashur te i siguroj mjetet financiare nga agjencitë e pavarura për këto procedura qe janë ne proces , sepse edhe sipas **LPP-se neni 9 - Përcaktimi i nevojave qe duhet përmbushur** paragrafi 2. e thekson qartë citoj : **Nëse pas vlerësimit të nevojave,ZKA vendos se vlerësimi i nevojave e arsyeton ushtrimin e aktivitetit të prokurimit, ZK Ai dërgon një kopje të këtij vlerësimi ZKF të autoritetit kontraktues. ZKF siguron**

se ka mjete financiare në dispozicion për prokurimin përkatës. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore,ZKF në pajtimme dispozitate aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullat Financiare do të sigurojnë se janë ndarë mjetetë mjaftueshme financiare për prokurimin përkatës në shumë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mundtë dalin si rezultati prokurimit në fjalë gjatë vitit aktual fiskal.

Edhe sipas Rregullave dhe Udhëzuesit për prokurim Publik pika 7 , se pari duhet te sigurohen mjetet finaciare e pastaj te shpërblehet me kontrate një operator,në ketë rast për OE.

Për OE, si ofertues i kompletuar është irelevante se ku e si i siguron mjetet financiare AK-ja, asaj i intereson qe oferta e saj te jete e kompletuar dhe me te lire, prandaj nuk është faji i Operatoreve Ekonomik, sepse AQP-konkretisht Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka mundur ti siguroj –zotoj mjetet nga kategoria mallra dhe shërbime e në ketë rast zotimi ka qene dashtë behet nga kategoria kapitale, sipas çmimit për njësi qe ka dalë mbi 1000.00 €uro.

Ne kërkesën e saj AK-ja konkret AKK-ja ka kërkuar pajisje qe e tejkalojnë vlerën mbi 1000.00 €,dhe paraprakisht është dashur te hulumtoj tregun dhe te marr çmimet referente se përafërsisht sa mund te kushtojnë këto pajisje te IT-se .

AK në këtë rast ka bere shkelje edhe te rregullave për prokurim publik te theksuara ne RRUOPP ku thuhet qartë ne piken 7, nënpika 8.7 Citoj : **Personat që kanë autoritet të nënshkruajnë kontratat janë të obliguar, para publikimit te Formularit B58 "Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar në mënyrë substanciale**,dhe këtë deklarate pra Deklaratën e Nevojave dhe Percaktueshmerinë e Disponueshmeris se Fondeve **(DNPDF)** te nënshkruara nga ZKA, ZKF- dhe Njësit kërkuese ta ngarkoj ne sistemin e prokurimit elektronik bashkë me Njoftimin për vendimin e AK-se. Ne këtë rast AK. nuk ka vepruar konform këtyre rregullave por ka përgatitur Njoftimin për Vendimin e AK-se te bashkangjitura me letrat standarde për operatoret ekonomik duke i shpërblyer me kontratë duke përfshirë edhe vet OE-ne ankuese për 5 llote ,madje edhe për Llot-in 4.

Pas Njoftimi për Vendimin e AK-se te dt.09.09.2020 AK-ja ka percjellur per publikim Njoftimin per Anulim te aktivitetit e prokurimit me dt.17.09.2020, ku ne arsyetimin e AK-së për anulim tek informatat shtesë te ketij njoftimi thuhet tekstualisht (citim) : **Pjesa (lot) 4- Furnizim me pajisje te TI-se per nevojat e Agjencise kundër Korrupsionit anulohet per shkak te mungeses se mjeteve te deklaruara nga ana e njesise se kerkeses - AKK citoj arsyetimin pas konsultimeve me Departamentin e Financave të AKK-se dhe Zyrtarin Kryesor Administrativ, kemi ardhur në përfundim se nuk ka mundësi ligjore të bëhet zotimi i mjeteve për blerjen e kompjuterëve në kategorinë e mallrave e shërbimeve, ku kanë qenë të planifikuara mjetet buxhetore për këtë aktivitet të prokurimit, pasi që vlera mbi 1,000.00 Euro, për njësi na e bënë të pamundur që mjetet të zotohen në kategorinë e planifikuar. AKK për vitin 2020 nuk ka të planifikuar në sistemin PIP asnjë projekt capital, prandaj duke u bazuar ne arsyeshmerine e dhene nga njesia e kerkeses-AKK ne duhet te bejm anulimin e kesaj pjese.**

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa të pranohet si e bazuar,dhe lënda ne fjale për **Llot 4** të kthehet ne RIVLERËSIM.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - OE. "ARITECH"Sh.P.K"- Kilometri i 10 Prishtinë-Lipjan